



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për shërbime të ekspertëve ndaj përfituesit, në kuadrin e studimeve të fizibilitetit, për programin “Infrastruktura bashkiake III/IV”, të financuar nga fonde të veçanta, të siguruara nga qeveria gjermane”.

Marrin pjesë:

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Mhill Fufi, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Arben Ristani, Vexhi Muçmataj, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia, Adelina Rista

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Anila Agalliu, Fatmir Mediu, Pandeli Majko, Tom Doshi, Vasilika Hysi, Silva Caka.

Të ftuar:

Ketrin Abazaj –specialiste, Sektori i Menaxhimit të Fondeve të Huaja në MTL.

Jovan Gjika – specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

Brikena Jazxhi - specialiste në Drejtorinë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave.

HAPET MBLEDHJA

Oerd Bylykbashi – Përshëndetje, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sot, në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit: “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, faza I, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për shërbime të ekspertëve ndaj përfituesit, në kuadrin e studimeve të fizibilitetit, për programin “Infrastruktura bashkiake III/IV”, të financuar nga fonde të veçanta, të siguruara nga qeveria gjermane”.

Relator i këtij projektligji është kolegu Bashkim Fino.

Të ftuar nga MTI janë: zonja Ketrin Abazaj, specialiste nga Sektori i Menaxhimit të Fondeve të Huaja në MTI, zoti Jovan Gjika, specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjiellës-Kanalizimeve, si dhe zonja Brikena Jazxhi, specialiste në Drejtorinë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave.

Fillimisht, do të bëhet një përmbledhje e shkurtër nga përfaqësuesit e ministrive, në lidhje me këtë projektligj.

Jovan Gjika – Mirëmëngjesi!

Unë jam koordinator i projektit dhe vij nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës - Kanalizimeve. Në kuadër të fazës së parë të programit infrastruktura bashkiake 3 dhe 4, që përfshin qytetet: Berat, Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Librazhd, Lushnjë dhe Kamzë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje granti, të financuar nga qeveria gjermane, financohen shërbimet e konsulentit teknik, i cili do të hartojë studimet e fizibilitetit, të cilat përfshihen në fazën studimore ose fazën e parë, që i paraprijnë më tej hartimit të projekteve të detajuara teknike, si dhe supervizionit të punimeve në terren.

Në bazë të natyrës së punës, shërbimeve dhe investimeve në ujësjiellës –kanalizime, këto shërbime për konsulentin teknik do të ndahen në 3 kontrata konsulence: Kontrata e parë përfshin rrethet: Berat, Kuçovë dhe Librazhd;

Kontrata e dytë përfshin rrethet: Delvinë, Gjirokastrë dhe Lushnjë, ndërsa kontrata e tretë përmban vetëm Kamzën.

Vlera e këtyre shërbimeve është 2 milionë e 140 mijë euro, në formë granti dhe është e financuar nga qeveria gjermane, vetëm për fazën e parë të projektit, hartimin e fizibilitetit.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Gjika!

Kanë ndonjë shpjegim tjetër përfaqësuesit e tjerë? Nuk ka.

Relatori i këtij projektligji, zoti Fino, ka fjalën!

Bashkim Fino – Unë kam disa pyetje dhe shumë paqartësi, që i kam thënë shpesh në komision. Desha të ndërhyja edhe dje. Unë kam një pyetje konkrete për përfaqësuesen e Ministrisë së Financave dhe një për koordinatorin. Në relacionin e këtij projektligji thuhet që shuma prej 2 milionë e 140 mijë eurosh, pa llogaritur atë 600 mijëshen e djeshme, që ishte llogaritur edhe ajo për konsulencë, do të përdoret vetëm për financimin e shërbimeve, të ekspertëve në mbështetje të MTI-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve. Çdo të thotë kjo? Po punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve që marrin rrogë nga ministria, do të bëjnë shërbimet e konsulentit teknik në rastin konkret dhe do të marrin ekstra, një pagesë tjetër? Kështu thuhet në relacion. 2 milionë e 140 mijë euro. Kjo nuk më duket normale. Dua të di se çfarë ishte shuma prej 600 mijë që kaluam dje, sepse nuk e kuptoj?

E dyta, zoti drejtues i mbledhjes së sotme, e kam thënë edhe një herë tjetër dhe po e them edhe një herë sot se grantet prandaj kanë një përfaqësues të Ministrisë së Financave. A di kjo përfaqësuese të na japë ndonjë shpjegim (megjithëse përfaqësuesit e sotëm janë të nivelit të ulët në raport me ne)? Mund të na vinin në nivel drejtori dhe më lart dhe jo në nivel specialisti dhe koordinatori.

Pse duhet t'i kalojmë në parlament grantet? Ju e dini shumë mirë që ne duhet të kalojmë vetëm kreditë, të cilat duhen kaluar dhe votuar patjetër në parlament, sepse ato kanë të bëjnë me shumë elemente të tjera, ndërsa granti nuk ka pse të kalojë në komision dhe në parlament.

Ministri ka marrë votëbesimin nga ne dhe mund t'i shpërndajë, të lidhë marrëveshjet, siç i ka lidhur dhe t'i ndajë nga grantet, të cilat nuk janë kredi. Nga kjo pikëpamje, unë nuk mendoj që duhet të ndalojë një parlament për të ngritur dorën për 600 mijë euro apo për 2 milionë e 140 mijë euro për shërbimet e konsulencës teknike. Këtë mund ta bëjë qeveria, me 2 projekt-vendime. Të merret parlamenti me 2 projektligje, sikur janë marrëveshje të papara, njëra me një vlerë prej 600 mijë eurosh apo tjetra për 2 milionë e 140 mijë euro. Po t'i marrësh e t'i lexosh në thelb, se ju të opozitës keni një fat të madh se nuk diskutoni nga ana profesionale në seancë plenare, por diskutoni për politikë se po të diskutoni profesionalisht, do të thoshit se çfarë janë këto 2 milionë e 600 mijë euro të këtij granti? Ju bëni diskutime të tjera.

Që të jem i qartë edhe unë, si relator, dua një përgjigje nga specialistët, sepse personalisht ndihem shumë i fyer të relatoj për një projektligj të tillë, që për mua, nuk ia vlen.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Fino!

Mesa kuptova ju refuzuat të bënit relatorin, sepse bëtë vetëm një pyetje për një problem parimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Në lidhje me substancën unë jam dakord me shqetësimin tuaj. Nëse duhet që grantet të vijnë në parlament për t'u miratuar, ia vlen ky lloj diskutimi.

Sigurisht që ekzekutivi nuk duhet të jepet me koncesion te parlamenti dhe ekzekutivi duhet të marrë përgjegjësitë e tij, të kryejë detyrën e vet dhe jo: për çdo firmë që vë ministri, t'ia kalojë parlamentit edhe për një vulë. Ky është një shqetësim, që e kemi ngritur edhe ne, e keni ngritur edhe ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ju kam dëgjuar me vëmendje sa herë keni qenë dakord me ne për këtë çështje. Unë e kuptoj që përfaqësuesit e ministrisë mund të mos kenë tagrin e mjaftueshëm, por ata duhet të shkojnë deri te ministrat përkatës për t'u përcjellë shqetësimin e Komisionit të Ligjeve.

Po e themi në sy të medieve, që ministri duhet të marrë përgjegjësinë dhe jo vetëm ministri përkatës, për çdo rast. Kur vë firmën, ai i qëndron asaj detyre që ka marrë me dekret të Presidentit. Besoj që në këto kushte, ia vlen të diskutohet. Në mos gaboj, edhe Komisioni i Ekonomisë ka ngritur një çështje të ngjashme për shqyrtim. Besoj se ky diskutim do të bëhet shumë shpejt, objekt shqyrtimi i këtij komisioni.

Në lidhje me projektligjin, si relator zoti Fino, a keni ndonjë gjë tjetër? Nuk pata asnjë të dhënë tjetër, nëse keni konstatuar ndonjë problem me projektligjin, në duhet marrë në shqyrtim apo jo?

Bashkim Fino – Zoti kryetar,

Jam shumë i lumtur që ju e përkthyet *mot a mot*, por në linjën dhe në gjuhën tuaj atë që unë thashë. Jam vërtetë shumë i lumtur që ju e përkthyet shumë mirë atë, që thashë unë, por e bëtë në një ngjyrë dhe në një mënyrë tjetër, siç e bëni ju, demokratët.

Unë bëra 2 pyetje për të cilat kërkoj përgjigje nga ekspertët, që kanë ardhur sot këtu. Mbasi të marr përgjigjen e ekspertëve, do të jem në gjendje të flas përsëri.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Fino!

Jam shumë dakord. Çfarë kanë për të thënë përfaqësuesit e ministrive për pyetjet e relatorit?

Urdhëroni, zonja Jazxhi!

Brikena Jazxhi - Përshëndetje!

Unë jam specialiste në Drejtorinë e Borxhit Publik në Ministrinë e Financave. Shqetësimi i zotit Fino është shumë i drejtë. Edhe Ministria e Financave ndan të njëjtin shqetësim për paraqitjen e granteve për miratim në parlament. Ministria e Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me ligjin “Për traktatet”, depoziton origjinalin e marrëveshjes pranë Ministrisë së Jashtme.

Së fundi, duke qenë se të gjitha grantet paraqiten për ratifikim në parlament, Ministria e Financave ka ngritur këtë shqetësim pranë Ministrisë së Jashtme, duke kërkuar që grantet të shkojnë vetëm për miratim final në KM. Ndërkohë, është e drejta dhe detyrimi i Ministrisë së Jashtme paraqitja e marrëveshjes për hyrjen në fuqi të saj për të ndjekur procedurën përkatëse. Sipas gjykimit të Ministrisë së Jashtme, marrëveshja përveç paraqitjes së grantit, ka një detyrim për palën shqiptare për të alokuar fondet e nevojshme për plotësimin e paketës ose të shumës së nevojshme për financim. Për këtë arsye Ministria e Jashtme i sjell në parlament grantet.

Gjithsesi, ne jemi duke diskutuar këtë çështje mes 2 ministrive dhe themi se do të zgjidhet shumë shpejt çështja e mosparaqitjes së granteve në formë projektligji në parlament.

Së dyti, desha të sqaroj se granti që vihet në dispozicion nuk do të financojë pagesa për punonjësit e Ministrisë së Transporteve apo Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve, por do të financojë shërbimin e një konsulenti, që do të asistojë këta punonjës, si për përgatitjen e studimeve, ashtu edhe për asistencë teknike për planet e detajuara të projektit. Për këtë mund të përgjigjet më në detaje Ministria e Transporteve.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Jazxhi!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e MTI-së.

Jovan Gjika – Siç e sqaroi edhe kolegja, shërbimet e konsulencës së një grupi ekspertësh të huaj dhe shqiptarë, janë organizuar në 3 kontrata, pra ka staf ndërkombëtar dhe shqiptar, i cili do të hartojë studimet e fizibilitetit për 8 qytete, duke përfshirë edhe zonat rurale, që integrohen te ndërmarrjet e reja pas reformës administrative. Pra, nuk bëhet fjalë që ne, punonjësit e shtetit do të marrim pagesa, por do të zgjidhet një konsulent teknik ndërkombëtar, i cili ka një staf dhe puna është e shtrirë, minimumi në 6 muaj, për hartimin e fizibilitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po jua shpjegoj: dje ishte konsulenti institucional, që mbështet shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve për ngritjen e kapaciteteve. Tjetër detyrë: hartimi i planit të bizneseve, hartimi i strategjive të tarifave, integrimin e të gjitha sistemeve dhe stafeve të trashëguara nga komunat të ndërmarrjet e reja të ujësjellës –kanalizimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino – E para, në relacion është shkruar gabim shuma prej 2 milionë e 140 mijë eurosh. Duhet të shënohet ashtu siç e shpjeguat ju tani, me konsulentë shqiptarë dhe të huaj, por dihet që shuma 600 mijë euro është për shërbim konsulence. Ajo që për të na dhënë mend, që konsulencia kryesore dhe kjo është konsulencia për këta që do të bëjnë fizibilitetin, se nuk po e kuptoj?

Ose duhen vënë të dyja shumat bashkë, 2 milionë e 700 mijë euro, sesa bëhen 2 projekte të ndara me shumat, që i përmenda më sipër. Për mendimin tim duhen vënë të dyja shumat bashkë dhe të kishte një ndarje brenda projekt-marrëveshjes apo brenda relacionit. Kështu nuk po arrij ta kuptoj se çfarë bëjnë ne dje, që miratuar 600 mijëshin dhe çfarë po bëjmë sot, që po miratojmë marrëveshjen me vlerë prej 2 milionë e 140 mijë eurosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Oerd Bylykbashi – I lutem përfaqësuesit të MTI-së, ta qartësoni relatorin për pyetjen që bëri! Ju lutem edhe një herë, të sqaroni problemin që ngre relatori!

Jovan Gjika – Dje nëpërmjet marrëveshjes me buxhetin prej 600 mijë eurosh, financohet konsulenti institucional.

Oerd Bylykbashi – Ju lutem të na shpjegoni se çfarë është ekzaktësisht!

Jovan Gjika – Hartimi i planit të bizneseve, hartimi i strategjive të tarifave, mbështetja e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve për rritjen e kapaciteteve, që ata të ecin vetë nesër kur këto investime të mbarojnë, ata të bëhen të qëndrueshëm dhe të mos trashëgojnë borxhe, të mos jenë ndërmarrje të falimentuara. Ky është konsulenti institucional.

Kjo marrëveshje e sotme është për konsulentin teknik, i cili harton fizibilitetet dhe më vonë, bën projekte të detajuara teknike, të cilat prokurohen dhe më pas kryhen supervizionet e punimeve.

Kështu janë modelet e KfW-së. Janë të ndara: konsulenti institucional dhe konsulenti teknik, në mënyrë që ata që përzgjidhen, të jenë vërtet të asaj fushe dhe të mos kemi një mish-

mash, që nesër të vuajmë ne, si zbatues. Marrëveshjet janë të ndara, sepse janë 2 burime financimi, janë 2 fonde.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Brikena Jazxhi - Marrëveshjet janë të ndara edhe për arsye të burimit të financimit. Njëri është kontribut i qeverisë gjermane (shuma prej 2 milionë e 140 mijë eurosh), ndërsa pjesa tjetër është grant zviceran. Duke qenë se KfW-ja është financuesi kryesor i programit, qeveria zvicerane vë në dispozicion një grant, të cilin ia lë në administrim KfW-së për të bërë një koordinim më të mirë të të gjitha financimeve. Mbështetja që jepet nëpërmjet 2 granteve, e para konsiston në fuqizimin institucional të ndërmarrjeve, pasi qeveria gjermane shqetësohet edhe për qëndrueshmërinë e investimit në afat të gjatë dhe kjo konsiston më tepër në qëndrueshmërinë financiare të këtyre ndërmarrjeve, të cilat do të jenë përfituese. Pjesa tjetër është mbështetje institucionale për ministrinë për zbatimin e projektit, pra për përgatitjen dhe zbatimin më tej të projektit.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Jazxhi!

Besoj se më shumë se kaq, nuk kanë ç'të shtojnë përfaqësuesit e 2 ministrive.

Zoti Fino keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Bashkim Fino – Argumentet e tyre ishin shkatërruese dhe miratuese, edhe për ju, edhe për mua.

Oerd Bylykbashi – Dakord. A ka pyetje nga kolegët për projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Meqë nuk ka pyetje të tjera, kam unë diçka. Përfaqësuesja e Ministrisë së Financave ngriti çështjen se ka edhe një kontribut të qeverisë shqiptare dhe kjo është arsyeja, që marrëveshja e grantit vjen në parlament. A mund të ma thoni se ku është ky kontribut në marrëveshje, sepse nuk po e shoh?

Brikena Jazxhi - Qeveria shqiptare në projekt përballon pjesën e kostove lokale, të TVSH-së dhe të taksave të tjera.

Oerd Bylykbashi – A ka ndonjë kosto të qeverisë shqiptare në këtë marrëveshje që vjen me këtë projektligj, sepse nuk po e shoh?

Brikena Jazxhi - Nuk është parashikuar një e kosto me vlerë të saktë.

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë: po investoni parlamentin për një çështje, që ju e keni ngritur si shqetësim dhe është mirë që pa i zgjidhur ju shqetësimet e brendshme, në lidhje me

menaxhimin e këtij lloj projekti, është mirë të mos investohet parlamenti. Nuk është arsye fakti që është bërë traditë e keqe, që i çohet çdo gjë parlamentit për miratim, për t'i marrë një vulë, se parlamenti nuk është noter, nuk vë vetëm vula. Ne kemi të drejtën për të vendosur pro ose kundër. Zgjidhni ju paraprakisht problemet dhe jo të vazhdojë parlamenti t'i miratojë këto grante, deri sa t'i zgjidhni ju.

E dyta, duke qenë se ne nuk e shohim projektin, por na vjen një projektligj, që rregullon vetëm një prej momenteve që për shkak të burimit të financimit ju po e ndani me pjesë, ne nuk e kemi vizionin e të tërës dhe për rrjedhojë, qasja vazhdon të jetë edhe më e gabuar. Ju po e investoni gabim parlamentin. Ekzekutivi nuk e ka këtë të drejtë. Ne jemi ligjvënës dhe nuk e kemi për detyrë këtë. Megjithatë, për të vazhduar më tej, a ka diskutime në lidhje me projektligjin? Nuk ka diskutime. Besoj se problematikat dolën edhe gjatë ngritjes së pyetjeve.

Kalojmë te votimi në parim të projektligjit.

Kush është pro?

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë te votimi nen për nen i projektligjit.

Kush është pro nenit 1?

Kundër? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro?

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi i projektligjit.

Kush është pro?

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Edhe një herë, ju kërkoj përfaqësuesve të ministrive që shqetësimin që ngritëm pavarësisht se këtu duhet të kishte përfaqësues të një niveli më të lartë (siç thotë me të drejtë edhe zoti Fino), me gjithë respektin për ju, por ky është komision parlamentar, i cili ka nevojë për

përgjigje, të cilat shkojnë në nivele përgjegjësie politike. Shqetësimin që ngritëm, duhet ta raportoni atje. Në të kundërt, do t'ju refuzohen grantet e sjella në këtë formë, herë të tjera.

Faleminderit, të nderuar kolegë!

E mbyllim mbledhjen për sot.

MBLEDHJA MBYLLET